



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec - Opština Orahovac

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Odeljenje za Geodeziju, Katastar i Imovinu



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 89
Br. prot. 10-01
Më 10.01.2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

Datë/a	05.01.2020
Referencë/a	
Për/Za?To :	Z. Smajl Latifi - Kryetar i K. Rahovec
CC:	Z. Fatmir Iska Nënkyetar i K. Rahovec
Përmes/Prekp/Through:	Drejtëpërdrejt
Nga/Od/From :	Z. Afrim Oruqi Jurist i Dipl. Drejtör i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Raporti vjetor i punës 2019

RAPORTI VJETOR I PUNËS

Janar – Dhjetor, 2019

Hyrje

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë gjatë gjithë vitit 2019 ka punuar në përputhje të plotë me planifikimet e bëra sipas planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë këtij viti. Në këtë raport janë paraqitur synimet, qëllimet, punët, projektet dhe aktivitetet kryesore që kanë karakterizuar KGJP-në gjatë gjithë vitit.

Gjatë vitit 2019 për të cilin po raportojmë, të tre sektorët e Drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	986	25,060 €
Gjeodezi	2345	28,810 €
Referenti	4,570+109 L.Z.	25,407 €
Totali	7,901+109 L.Z.	79,277 €

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Centrix: 45341
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

Synimet kryesore të KGJP-së për vitin 2019 ishin:

- Themelimi dhe funksionalizimi i plotë i Komisionit për Komosacion.
- Zgjerimi i stafit të KGJP-së me kuadrin e nevojshëm, të zyrarit për pranimin e lëndve.
- Vazhdimi i skenimit masiv të materialit të pa skenuar.
- Vazhdimi i migrimit të zonave të pa migruara në ZK Rahovec.
- Ofrimi i shërbimeve tona edhe në dy pika lokale në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc gjatë aplikimeve të subvencioneve.

Qëllime kryesore kishim:

- Ngritjen e profesionalizmit të gjeodetve në lidhje me ofrimin e shërbimeve sa më profesionale.
- Mirëmbajtjen e Kadastrit sipas detyrës zyrtare.
- Funksionimin sa më të mirë të sektorve të Kadastrit, Gjeodezis dhe Pronës.
- Ofrimin e produkteve- shërbimeve në kohë reale.

Objektivat tona të përhershme, që karakterizuan edhe këtë vit, janë:

- Përmirësimi i ofrit të shërbimeve- produkteve sa më profesionale gjeodezike dhe konformë akteve nën ligjore të Agjensionit Kadastral të Kosovës.
- Zvogëlimi në kohë të arsyeshme të zgjidhjes së lëndve të Gjeodetve.
- Bashkëpunimi me operator privat të licencuar të gjeodetve.
- Integrimi i zonave të pa migruara në sistem.

AKTIVITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONË GJATË VITIT 2019

- Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë vitit po i paraqesim të përmbledhura sipas periudhave 6 mujore, siç vijon:
- Në gjashtëmujorin e parë Janar- Qershor,
- Në gjashtëmujorin e parë në Kuvendin e Komunës së Rahovecit Drejtoria për KGJP i ka prezentuar dhe përfunduar këto pika:

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Centrix: 45341
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave për rrugën transit në Rahovec i cili është mbajtur me datën 27.02.2019.

Shqyrtimi i Vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër në mbledhjen e mbajtur me datën 29.03.2019.

Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim - vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës Komunale,

Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim - vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër për raste të veçanta,

Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim - vendimit të Kryetarit të Komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 110000 m² në Rahovec,

Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim - vendimit të Kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 42099 m² në Rahovec, katër pikat e lartëcekura janë prezantuar me datë 28.06.2019.

- Në bazë të planit për vitin 2019 kemi inqizuar dhe përfunduar disa procese të shpronësimit për interes të përgjithshëm për hapje të rrugëve të reja, siq janë: shpronësimi dhe zgjerimi i rrugës “Edit Durham”, akt vlerësimi i hapjes së rrugës publike nëpër parcelat e zonës kadastrale në Rahovec të fabrika e Plastikës etj.
- Kemi filluar në bashkëpunim me Agjensionin Kadastral të Kosovës dhe e kemi përfunduar inventarizimin dhe skenimin e dokumentacionit, i cili nuk ishte i skenuar.
- Zyrtarisht kemi inqizuar komplet rrugën që na dërgon te Maja e Shkodranit, rrugën Rahovec-Xërxë, Rahovec-Malishevë, rrugë tranzite deri te hyrja për tranzit për Therandë etj.
- Me kërkesë të avokatit të komunës, kemi përgatitur historiatet e parcelave kadastrale në nivel komune dhe kemi prezentuar dokumentacionin e kërkuar.
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për KPF për shpallje me interes të përgjithshëm të lëndëve në nivel Komune.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Adresa: Xhelal Hajda - Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Centrix: 45341
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

Në gjashtëmujojin e dytë Korrik- Dhjetor

Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë vitit po i paraqesim të përmbledhura sipas periudhave 6 mujore, siç vijon:

- Drejtoria e KGJP i ka prezentuar këto pika në Kuvendin e Komunës gjatë gjashtëmujoit të dytë:
- Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim - vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me sipërfaqe prej 11.000m², me datë 26.09.2019.
- Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim - vendimit të Kryetarit të komunës për këmbimin e pronës komunale me sipërfaqe prej 25.099m², me datë 26.09.2019.
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit paraparak për shpalljen e interesit të përgjithshëm për Hapjen e rrugës publike në Z.K - Xërxë, me datë 26.12.2019.
- Në bashkëpunim të ngushtë me Agjensionin Kadastral të Kosovës kemi përgatitur linjën zyrtare për ofrimin e shërbimeve edhe në pika tjera të komunës, si në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc, ky proces ka filluar shumë mirë dhe është duke treguar rezultatet e veta në ofrimin e shërbimeve qytetarëve edhe në këto zona.
- Me kërkesë nga DKRS janë evidentuar të gjitha parcelat publike në ZK si në Rahovec, Dejnë Apterushë etj, për projektimin e fushave sportive.
- Me kërkesë të kryetarve të fshatrave kemi kufizuar rrugë publike, sheshet, varrezat e fshatit, hapësirat e shkollës, rrugë fushore etj.
- Me kërkesë zyrtare të Inspektoratit kemi identifikuar parcelat të uzurpuara dhe kemi nxjerr aktvendime për uzurpim.
- Kemi përfunduar materialin e kërkuar nga Banka Botërore në lidhje me projektin për modernizimin e sistemit të ujitjes në të gjitha zonat kadastrale.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Centrix: 45341
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

Synimet kryesore e KGJP-së për vitin e ardhshëm janë:

- Themelimi dhe funksionalizimi i plotë i Komisionit për Komosacion.
- Lirimi i pronave të uzurpuara publike në nivel të Komunës.
- Vazhdimi i skanimit masiv në bashkëpunim me AKK-në.
- Vazhdimi i migrimit të zonave të pa migruara.
- Vazhdimi i ofrimit të shërbimve edhe në dy pika tjera lokale gjatë aplikimit të subvencioneve për bujqësi.

Rahovec

Më datë 06/01/2020



Afrim Oruqi

Drejtör

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Centrix: 45341
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>